



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:153286
Datë: 10.06.2024
Numri i dokumentit: 05804517

KP.nr. 27/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike paditësit “TEB” Sh.A., me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson sipas autorizimit “Credica “L.L.C me seli në Prishtinë kundër të paditurve 1. D.P.Z “Llamarist Kulmi” me numër të biznesit 80269935 me seli në Pejë rrugë “...” n.r 164, 2. B .V. me adresë të banimit në rrugën “...” nr. 164 Pejë, dhe 3. A.V. me adresë të banimit në rrugën “...” nr. 164, Pejë, me objekt kontesti kthimi i borxhit sipas marrëveshjes mbi kredinë, vlera e kontestit 15.573.1 Euro, jashtë seance me datën 10.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komeriale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, shpallet JO KOMPETENT në pikëpamje lëndore, për të gjykuar në çështjen kontestimore të paditësit “TEB” Sh.A., ndaj të paditurve 1. D.P.Z “Llamarist Kulmi”, 2. B .V., 3. A.V.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj t'i dorëzohet Departamenti për Çështje Ekonomike pranë kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Paditësi “TEB” Sh.A., përmes të autorizuarit të tije, më datën 29.05.2024 pranë kësaj Gjykate ka parashtruar padi për pagimin e borxhit sipas marrëveshjes mbi kredinë ndaj të paditurve 1. D.P.Z “Llamarist Kulmi”, 2. B .V., 3. A.V..

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, vlerësoj se Departamenti i Përgjithshëm pranë Gjykatës Komeriale nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Gjykata erdhi në përfundim se nuk është e kompetencës lëndore për të gjykuar këtë çështje, mbështetur në nenet 13, par 1. lidhur me par.1.6, 1.7, 1.8, 1.10 dhe 1.13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale (Ligji nr. 08/L-15).

Në këtë çështje juridike, gjykata vlerëson se objekt i kontestit është kthimi i borxhit sipas marrëveshjes së kredisë, kompetente për shqyrtimit e kësaj çështje është Departamenti për Çështje Ekonomike pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, kjo bazuar në nenin 13, par.1 nën par.1.1 i Ligjit për Gjykatën Komerciale (Ligji nr. 08/L-15) i cili përcakton “1. Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: par. 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre;” lidhur me par. 2 që përcakton se: “2. Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike”.

Gjykata bëri shqyrtimin e kompetencës lëndore sipas detyrës zyrtare mbështetur në nenin 17 dhe 19 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Prandaj, bazuar në 13, par. 1, nën par. 1.7 lidhur me par. 2 dhe 3 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenin 17, 19, 29, 387 par. 1 pika (u) dhe nenit 392 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.27/24, datë 10.06.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.